

SONILA BOÇI

**ÇËSHTJA E MINORITETEVE NË KUADËR
TË KONSOLIDIMIT TË SHQIPTAR
NË PERIUDHËN MIDIS DY LUFTËRAVE***

Lufta e Parë Botërore zbehu sukseset e brishta të shtetit shqiptar në procesin e konsolidimit të tij. Vitet 1919-1921 u bënë dëshmitarë të një situatë politike të mbushur me tension, pasiguri dhe përpjekje për të rikonfirmuar statusin ndërkombëtar dhe kufijtë shtetërorë të shtetit shqiptar. Edhe në këtë situatë të vështirë, i vendosur përballë pretendimeve territoriale të fqinjëve, shteti shqiptar tregoi predispozicion pozitiv ndaj minoriteteve që jetonin në Shqipëri.

Asambleja e Lidhjes së Kombeve në sesionin e 15 dhjetorit të vitit 1920, u kërkoi shteteve kaukaziane dhe ballkanike, që pretendonin të bëheshin anëtarë të saj midis të cilëve edhe Shqipërisë, të merrnin masa të domosdoshme, që në frymën e traktateve mbi minoritetet të rregullonin legjislacionin e brendshëm¹. Qeveria shqiptare u tregua menjëherë e gatshme ta pranonte këtë kusht. Por qeverisë shqiptare nuk iu kërkua vetëm rregullimi i legjislacionit të brendshëm, por dhe nënshkrimi i një deklaratë para Lidhjes së Kombeve për mbrojtjen e minoriteteve. Si rregull, imponimi i këtyre detyrimeve u bëhej shteteve që ishin krijuar nga Sistemi i Versajës, ose shteteve që në përfundim të Luftës së Parë Botërore e kishin zgjeruar dukshëm territorin e tyre². Shteti shqiptar nuk i

* Kumtesë mbajtur në Konferencën shkencore me temë: “Shqipëria, nga Perandoria Osmane drejt Pavarësisë dhe shtetformimit (Arritje të reja të historiografisë)”, organizuar nga Universiteti European i Tiranës, më 30 mars 2010.

¹ Ledia Dushku, “Debatet shqiptaro-greke dhe Lidhja e Kombeve (1920-1922)”, në: *Studime Historike*, 3-4, Tiranë: 2006, f. 76.

² Sipas vendimeve të Konferencës së Paqes, traktate për minoritetet nuk do t'i kërkoheshin shteteve të krijuara tashmë, të tilla traktate do të ishin të detyruar të nënshkruanin vetëm shtetet që ishin krijuar rishtazi, apo kishin zgjeruar së tepërmi territorin. Për më tepër në lidhje me këtë shih: Michael Burns, “Disturbed Spirit: minority rights and New World Order, 1919 and the 1990s” në: *New European Order 1919 and 1991*, edited by Samuel F. Wells Jr. and Paula Bailey Smith, Washington: Woodrow Wilson International Center, 1996, f. 46.

përgjigjej asnjërës nga këto kategori. Atëherë pse iu kërkua shtetit shqiptar të nënshkruante një deklaratë para Lidhjes së Kombeve, ku të merrte angazhime të qarta për mbrojtjen e minoriteteve?

Dhimitër Berati në librin e tij *Qëllimet dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve*, shprehet se nënshkrimi i një deklaratë për mbrojtjen e minoriteteve nuk ishte kusht për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, por “Shqipëria i plotësoi pa asnjë kundërshtim gjithë ato të drejta që vetë Lidhja e Kombeve i ka gjetur të arsyeshme”³. Ky konstatim lë të nënkuptohet se nënshkrimi i kësaj deklaratë për mbrojtjen e minoriteteve ishte lënë në vullnetin e qeverisë shqiptare.

Në të vërtetë, Deklarata u nënshkrua më 2 tetor 1921, pra gati 10 muaj më vonë nga pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Kështu, juristi dhe diplomati Dh. Berati pohon me të drejtë se nënshkrimi i Deklaratës nuk ishte kusht për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, por nga ana tjetër nuk mendoj se ishte vetëm akt i një vullneti të mirë nga ana e qeverisë shqiptare. Edhe nëse kjo kërkesë e Lidhjes së Kombeve të mos kishte karakter detyrues, Shqipëria ishte e detyruar ta nënshkruante një deklaratë për mbrojtjen e minoriteteve dhe kjo për shumë arsye. *Së pari*, një gjë të tillë e diktonte situata ndërkombëtare, në të cilën gjendej shteti shqiptar. Me pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ekzistenca e saj si shtet i pavarur siguroi njohje kolektive, por qeveria shqiptare ende nuk ishte njohur ndërkombëtarisht dhe pritej të thuhej fjala e fundit për kufijtë e shtetit shqiptar. Për më tepër, fqinjët e Shqipërisë, veçanërisht Greqia, kishte ngritur pretendimin, që jo vetëm territoret e shtetit shqiptar me shumicë greke t’i kalonin asaj, por edhe ato me shumicë shqiptare. Kryeministri grek, Venizelos, ishte shprehur në Konferencën e Paqes në Paris se “do të ishte në kundërshtim me të gjithë drejtësinë, nëse në popullin e dhënë, shumica që zotëronte një formë më të lartë qytetërimi i duhej t’i nënshtrohej pakicës që zotëronte një qytetërim më inferior”⁴. Në këtë situatë, shtetit shqiptar i duhej të bënte disa lëshime për minoritetet. Ato do të shërbenin si garanci më shumë, Fuqive të Mëdha, për standarde në mbrojtjen e minoriteteve, gjë që do të ndihmonte në rikonfirmimin e kufijve të shtetit shqiptar të vitit 1913.

³ Dhimitër Berati, *Qëllimet dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve*, Tiranë: 1931, f. 16.

⁴ Margaret Macmillan, *Paris 1919, gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Tiranë: “Plejad”, 2006, f. 412.

Së dyti, nënshkrimi i Deklaratës së Lidhjes së Kombeve për mbrojtjen e minoriteteve ishte një hap përpara në krahasim me regjimin e kapitulacioneve, që ishte trashëguar nga Perandoria Osmane, i cili ishte pranuar edhe në Statusin Themeltar të Principatës shqiptare të drejtuar nga Princ Vidi. Në ndryshim nga ky regjim, Deklarata parashikonte që të drejtat e minoriteteve në Shqipëri të siguroheshin nga shteti shqiptar dhe të mbroheshin nga organizmat e Lidhjes së Kombeve. Statusi i Lidhjes së Kombeve nuk lejonte asnjë shtet që nuk ishte anëtar i këshillit të saj të ngrinte në këshill çështje që lidheshin me minoritetet. Kjo pengonte ndërhyrjen e shteteve fqinje të Shqipërisë, të cilat kinse në mbrojtje të minoriteteve vazhdonin politikën e tyre irredentiste në territorin shqiptar. Në këtë frymë, Lidhja e Kombeve nuk pranoi kërkesat e qeverisë greke për të ngritur pranë Këshillit të saj, çështje që lidheshin me trajtimin e minoritetit grek nga qeveria shqiptare⁵.

Më 2 tetor 1921, përfaqësuesi i shtetit shqiptar pranë Lidhjes së Kombeve, Fan Noli, nënshkroi Deklaratën për mbrojtjen e minoriteteve dhe deklaroi në emër të shtetit shqiptar se vendi i tij “do të merrte parasysh çdo rekomandim që mund t’i bëhej për minoritetet nga Lidhja e Kombeve”⁶. Në nenin e parë të Deklaratës thuhej se dispozitat e saj do të njihen si ligj bazë në Shqipëri⁷. Duke qenë se Deklarata si akt ndërkombëtar kishte përparësi ndaj atyre kombëtare, në të gjitha Statutet themeltare të periudhës midis Dy Luftërave në Shqipëri nuk u përfshinë norma specifike për minoritetet⁸.

Gjatë vitit 1922, qeveria shqiptare ndërmori një studim për të parë gjendjen e minoriteteve dhe shkallën e të drejtave të tyre. Studimi përmblihte të dhëna mbi numrin e minoriteteve në Shqipëri dhe të institucioneve arsimore, fetare, bamirëse etj. Rezultatet e përgjithshme të këtij studimi ishin se në Shqipëri jetonin minoritete greke, malazeze dhe vllahe, të cilat, në përputhje me dispozitat e Deklaratës së 2 tetorit 1921, kishin shkolla në gjuhën e tyre amtare, si dhe institucione fetare të

⁵ Dh. Berati, *Qëllimet dhe organizimi ...*, f. 18.

⁶ *Po aty*.

⁷ Cour permanente de Justice Internationale, *École minoritaire en Albanie*, documents transmis par le Secrétaire General de la Société des Nations, janvier 1935, f. 11.

⁸ Luan Omari, “Kushtetuta e Shqipërisë dhe pakicat kombëtare”, në: *Tribuna Juridike*, Nr. 40 (1), 2003, f. 8.

pavarura⁹. Anëtarëve të minoritetit u ishte dhënë mundësi e barabartë për punësim në institucionet shtetërore, madje dhe mundësi përfaqësimi në Parlamentin Shqiptar.

Historia e shtetit shqiptar në periudhën midis Dy Luftërave do të dëshmojë se të drejtat që parashikonte Deklarata për Mbrojtjen e Minoriteteve në Shqipëri do të keqpërdorëshin nga shtetet ballkanikë fqinjë. Në jo pak raste, ato shfrytëzuan vullnetin pozitiv të shtetit shqiptar ndaj minoriteteve, por dhe dobësinë e tij, për të nxitur minoritetet të kundërshtonin përpjekjet e shtetit shqiptar për konsolidimin e institucioneve kombëtare. Kjo e vendosi qeverinë shqiptare në një pozicion mbrojtës dhe ndikoi në ngadalësimin e këtij procesi.

Pengesa të tilla hasën përpjekjet e shtetit shqiptar për vendosjen e institucioneve fetare në baza kombëtare. Reagim të minoriteteve që jetonin në Shqipëri shkaktoi nisma e të krishterëve shqiptarë të rritit ortodoks për të themeluar Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH)¹⁰. Pas Kongresit të Beratit (1922) reagues minoritetet greke, malazeze dhe vllehe, për të cilët shpallja e autoqefalisë u shndërrua në një nxitje të mëtejshme për të kërkuar mbrojtës të jashtëm¹¹. Ankesave të tyre të shumta në Lidhjen e Kombeve, qeveria shqiptare iu përgjigj menjëherë duke garantuar se të gjitha minoritetet do të lejoheshin të zgjidhnin priftërinjtë e tyre, si dhe të zhvillonin ritet fetare në gjuhën amtare.

Situata ndërmjet shtetit shqiptar dhe minoriteteve u përkeqësua sërish në prag të Kongresit të Dytë të KOASH-it. Minoritetet kundërshtuan nenin 16 të statutit të KOASH-it të miratuar më 16 qershor 1929, i cili parashikonte që drejtuesit e lartë të KOASH-it duhet të ishin “prej gjaku e gjuhe shqiptare dhe të kishin nënshtetësi shqiptare”¹². Ashtu siç vëren me të drejtë studiuesi italian Roberto Maroco dela Roka, as

⁹ Dh. Berati, *Qëllimet dhe organizimi ...*, f. 26.

¹⁰ Për më tepër shih: Fatmira Rama, “Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i Dytë Panortodoks i Kishës Autoqefale Kombëtare” në: *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1993, f. 66.

¹¹ Beqir Meta, “Përpjekjet për konsolidimin e institucioneve fetare 1925-1935”, në: *Studime Historike*, 3-4, 2008, Tiranë: 2009, f. 98.

¹² Për më tepër shih: Aurela Anastasi, “Statusi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe evoluimi i tij” në: *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare ...*, f. 56.

autoqefalia, as statuti i KOASH-it nuk ishte në kundërshtim, me Deklaratën e 2 tetorit 1921¹³. Statusi nuk i ndalonte minoritetet të kishin klerikët lokalë, të cilët të meshonin në gjuhën e tyre amtare, pasi ai bënte fjalë vetëm për nivelet e larta të klerikëve. Madje, një muaj para Kongresit të Korçës, Visarion Xhuvani, mitropoliti i ardhshëm i KOASH-it, kish mundur të siguronte nga qeveria e Tiranës emërimin e një peshkopi serb për pakicën sllave të Shkodrës¹⁴. Arsyeja e vërtetë e refuzimit të krijimit të KOASH-it ishte se ajo i hiqte qeverive fqinjë, veçanërisht asaj greke mundësinë të vazhdonte politikën helenizuese në Shqipërinë e Jugut.

Pengesa edhe më të mëdha hasi qeveria shqiptare në përpjekjet e saj për konsolidimin e institucioneve të arsimit kombëtar shqiptar. Duke qenë se nacionalizmi shqiptar ishte mbështetur në gjuhën shqipe, shkolla shqiptare ishte shtylla kryesore e identitetit kombëtar shqiptar dhe forcimi i saj ishte detyra kryesore e të gjitha qeverive shqiptare në periudhën midis Dy Luftërave. Nga ana tjetër, vendosja e arsimit nën kontrollin shtetëror ishte e domosdoshme për shkak të numrit të madh të institucioneve arsimore të financuara nga qeveritë greke dhe serbe që ekzistonin në Shqipëri që nga koha e sundimit osman. Në fund të shek. XIX në Shqipëri kishte më shumë se 1 000 shkolla greke të përqendruara kryesisht në Shqipërinë e Jugut¹⁵.

Gjatë viteve '20 qeveritë shqiptare bënë përpjekje të vazhdueshme, që, pa shkelur angazhimet e mara në deklaratën e 2 tetorit 1921, të minimizonin ndikimin negativ që shkollat e hapura me fondet e shteteve fqinjë kishin në mbrytjen e identitetin kombëtar të shqiptarëve. Në jug të vendit numri i shkollave në gjuhën greke, ra në mënyrë të ndjeshme për t'ia lënë vendin shkollave në gjuhën shqipe (nga 320 shkolla që numëroheshin në fillim të shekullit, në 64 në fillim të viteve '30)¹⁶.

¹³ Roberto Moroco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri, 1920-1944*, Tiranë: "Elena Gjika", 1994, f. 156.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ Sipas të dhënave të konsullatës franceze në Janinë, në vitin 1882 vetëm në vilajetin e Janinës, që përfshinte gjithë Shqipërinë e Poshtme (duke përfshijtur rrethet e Kolonjës, të Korçës e të Pogradecit), kishte 643 shkolla greke për djem e mikse me 736 mësues dhe 22 shkolla për vajza me 40 mësues. *Historia e Popullit Shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. II, Tiranë: "Toena", 2002, f. 248.

¹⁶ B. Meta, "Përpjekjet për konsolidimin e institucioneve ...", f. 98.

Pavarësisht nga kjo, qeveria greke, në kundërshtim me ligjet e shtetit shqiptar, vazhonte të financonte shkolla private dhe në qytete dhe krahina thjesht shqiptare, duke i përdorur këto institucione në dëm të interesave kombëtare.

Edhe shteti i sapokrijuar serbo-kroato-slloven zotëronte disa institucione arsimore në Shkodër “njëna për të krishterët ortodoksë të atij qyteti dhe tjetra për ata të katundit Vrakë afër Shkodrës”¹⁷. Përpjekjet e qeverisë shqiptare për të bindur atë jugosllave të ndalonte subvencionimin e këtyre shkollave, me argumentin se, nëse kjo popullsi, që jo e gjitha ishte sllave, do të ketë nevojë për shkolla, atëherë shteti shqiptar do të “interesohej për to, sikurse interesohet për çdo minoritet race”¹⁸, nuk gjetën mirëkuptimin e kësaj të fundit.

Qeveria rumune, nga ana tjetër, subvenciononte me anë të një organizate në Selanik shkollat e minoritetit lingvistik vllah. Në vitin 1927, Ministria e Arsimit arriti t’i marrë në dorëzim këto shkolla, por në viti 1932 pas përpjekjeve të ministrit të Rumanisë në Durrës, Vasil Stoika këto shkolla iu kthyen komunitetit vllah me të drejta shkollash minoritare si ato greke¹⁹. Duke qenë se të gjitha këto shkolla vepronin si entitete të pavarura dhe nuk i nënshtroheshin asnjë kontrolli nga ana e qeverisë shqiptare, ishin shndërruar në qendra të propagandës antikombëtare.

Në fillim të viteve ’30, përpjekjet për ta vendosur arsimin në Shqipëri në baza kombëtare morën një impuls të ri. Në vitin 1932, ministri i Arsimit Hil Mosi ndërmori një reformë, e cila në thelb synonte ta vendoste arsimin në Shqipëri nën kontrollin shtetëror dhe largimin e influencave të huaja nga arsimi kombëtar. Kjo reformë u iniciua dhe u mbështet nga Mbreti Zogu I. Më 21 nëntor 1932, në fjalën e tij përshëndetëse me rastin e hapjes së sesionit të ri parlamentar, Mbreti Zog, deklaroi se arsimi kombëtar do t’i jepej një rol i rëndësishëm. “Brezi i ri, - tha ndër të tjera ai, - do të ketë avantazhin e një kulture kombëtare e pacenuar nga ndikime të huaja”²⁰.

Ka disa arsye që Mbreti Zog dhe qeveria shqiptare ndërmori një reformë të tillë pikërisht në fillim të viteve ’30. Mbreti Zog, pas ulje

¹⁷ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), viti (më tej: V.) 1922, Dosja (më tej: D.) 164, fl. 10.

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Koleksioni i dokumenteve britanike, A.V.35.

²⁰ *Po aty*, A.V.36.

ngritjeve të tij në pushtet, kishte filluar ta ndjente veten më të fortë dhe pozitën e tij më të konsoliduar në politikën e brendshme. Ai mendonte se kishte ardhur koha ta çlironte veten nga tutela italiane që sa vinte dhe forcohej. Mbreti Zog kishte provuar një herë, jo fare pa sukses, t'i impononte kushtet e veta Italisë në vitin 1931 dhe ndoshta mendoi se ishte koha të merrte dhe një hap tjetër në këtë drejtim²¹. Të frikësuar nga shtimi i institucioneve private arsimore italiane në Shqipëri dhe ndikimin që këto kishin në edukimin e brezit më të ri të shqiptarëve. Mbreti Zog dhe qeveria shqiptare menduan të gjejnë mënyrat për ta neutralizuar këtë ndikim. Për këtë qëllim, më 14 shtator 1932, ministri i Arsimit, Hil Mosi përgatiti një projektligj, sipas të cilit u ndalohej fëmijëve shqiptarë të frekuentonin shkollat e huaja, madje prindërit që i dërgonin fëmijët e tyre në shkolla të huaja viheshin para përgjegjësisë penale dhe dënoheshin me gjoba të rënda, deri në burg²². Pas vdekjes së Hil Mosit në fund të dhjetorit 1932, pasardhësi i tij, Mirash Ivanaj zbatoi një politikë më radikale për kombëtarizimin e arsimit, duke mbyllur të gjitha shkollat private në Shqipëri, madje dhe ato të institucioneve shtetërore. Për të mbështetur reformën e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, 10% të buxhetit të përgjithshëm shtetëror parashikohej t'i akordohej arsimit. Në prill 1933, ministri Mirash Ivanaj, i kërkoi Parlamentit të ndryshonte nenet 206 dhe 207 të Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, i cili lejonte hapjen e shkollave private. Parlamenti e miratoi dhe Mbreti Zog e sanksionoi menjëherë. Rezultati më pozitiv i kësaj reforme ishte se u vu re një përparim jo i parëndësishëm në fushën e arsimit kombëtar²³.

Por nga ana tjetër, reforma shkaktoi mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore të huaja, përfshirë ato të klerit katolik dhe shkollat amerikane e franceze. Ajo preku dhe shkollat e minoriteteve. Kështu u mbyll shkolla ortodokse në Shkodër e kontrolluar nga jugosllavët dhe shkolla për minoritetin malazez në fshatin Vrakë u vendos nën kontrollin qeveritar. Të njëjtin fat pati dhe shkolla fillore minoritare e vllahëve në Korçë²⁴. Gjithashtu u mbyllën dhe 10 shkollat

²¹ *Po aty.*

²² Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: "Toena", 2009, f. 501.

²³ *AIH*, Koleksioni i dokumenteve britanike, A. 5-59, fl. 6-7, Legata britanike në Durrës për FO, R.M. Hodgson për John Simon, çështja e reformës arsimore të Mirash Ivanajt.

²⁴ *Po aty.*

private të minoritetit grek në Shqipërinë e Jugut, duke e vendosur arsimin e minoriteteve në Shqipëri plotësisht nën kontrollin shtetëror.

Të gjitha këto ngjarje patën rrjedhojë një situatë tejet të rënduar diplomatike për shtetin shqiptar. Krahas Italisë ndaj të cilës këto masa drejtoheshin në vetë të parë, kundër reformës arsimore, reagan ashpër Greqia dhe Rumania, të cilave ky vendim u hoqi mundësinë e ndërhyrjes në çështje të brendshme të shtetit shqiptar. në të kundërtën, Jugosllavia, e cila e shihte me simpati acarimin e marrëdhënieve shqiptaro-italiane i deklaroi Mbretit Zog me anë të ministrit jugosllav në Durrës se “po të kishte ndodhur një gjë e tillë gjashtë muaj më parë do të kishte qenë detyra e tij të protestonte me zell më të madh, por meqenëse shkollat italiane janë mbyllur ai nuk ka arsye ta mërzisë qeverinë shqiptare duke ngritur tanimë një çështje pa kurrfarë rëndësie”²⁵.

Britania e Madhe ndonëse mbështeste reformën arsimore të M. Ivanajt nuk mbështeste radikalizmin e saj. “Pranohet se sistemi i arsimit siç ishte përpara ardhjes së Mirash Ivanajt kishte nevojë për reforma, - i shkruante në maj 1933, ministri britanik në Durrës, Hodgson, qendrës së tij, - dhe ka argumente për të mbështetur fushatën e qeverisë shqiptare kundër shkollave private, por megjithëkëtë, çasti i zgjedhur për të bërë reforma në shkollë kaq të gjerë është i papajtueshëm, siç ishte e kotë të armiqësohej Italia në një kohë kur ndihma e saj financiare kërkohet urgjentisht”²⁶.

Reagimin më të ashpër ndaj kësaj reforme të qeverisë shqiptare e pati qeveria greke. Historiografia shqiptare e ka lidhur reagimin e qeverisë greke vetëm me mbylljen e shkollave private. Prof. A. Puto pohon se qeveria shqiptare mbylli vërtet 10 shkolla private të hapura në zonën e minoritetit grek, por me fondet e saj hapi 45 shkolla për këtë popullsi²⁷. Ajo që nuk është përmendur në literaturën historike në lidhje me këtë çështje është se qeveria shqiptare nuk u mjaftua thjesht me mbylljen e shkollave private. E frustruar nga ndërhyrjet e shumta të qeverisë greke në përzgjedhjen e arsimtarëve të minoritetit grek dhe në programet e shkollave minoritare, reforma arsimore preku dhe programet dhe kuadrin

²⁵ *Po aty*, A. 5-60, fl. 8, Legata britanike në Durrës për FO, R.M. Hodgson për John Simon, mbi reformën arsimore, reagimet italiane, rumune dhe jugosllave, 30 maj 1933.

²⁶ *Po aty*, A. 5-59, fl. 6-7, Legata britanike në Durrës për FO, R.M. Hodgson për John Simon, çështja e reformës arsimore të Mirash Ivanajt, 3 maj 1933.

²⁷ A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 502-503.

arsimor të minoritetit grek. Kështu, u vendos që në shkollat minoritare, mësimet të zhvilloheshin në gjuhën shqipe dhe greqishtja do të ishte si lëndë e veçantë vetëm për 6 orë në javë. Mësuesve iu dha kohë një vit për të mësuar shqipen, ose të linin vendin e punës. Mësuesit e shkollave minoritare do të caktoheshin vetëm nga Ministria e Arsimit. Minoriteti grek protestoi ndaj këtyre masave duke refuzuar t'i dërgonte fëmijët në shkollat që kishte hapur qeveria shqiptare gjatë vitit shkollor 1933-1934²⁸. Ndërkohë qeveria shqiptare u përpoq me forcë të zbatonte reformën arsimore dhe në zonën e minoritetit grek²⁹.

Të gjitha këto vendime shkaktuan një tërmet në marrëdhëniet shqiptaro-greke. Shtypi dhe opinioni publik në Greqi u nxit të protestonte kundër qeverisë shqiptare. Në verë 1934, minoriteti grek në Shqipëri u nxit të nënshkruante një peticion drejtuar Lidhjes së Kombeve. Në gusht 1934 çështja i kaloi për shqyrtim komisionit të minoriteteve për Lidhjen e Kombeve, i cili shqyrtoi si pretendimet e minoritetit grek ashtu dhe vërejtjet e qeverisë shqiptare. Në fillim të shtatorit 1934, anëtarët e komisionit shpallën se numri i orëve të mësimit të gjuhës amtare përbënte “një farë përmbysje të roleve të caktuara respektivisht gjuhës amtare të fëmijëve dhe gjuhës zyrtare”, gjë që sipas komisionit ishte shkelje e paragrafit të parë të nenit 6 të Deklaratës së 2 tetorit 1921. Për të qenë të sigurt në këtë përcaktim, ata kërkuan opinionin e seksionit juridik të Lidhjes së Kombeve, i cili konfirmoi mendimin e komisionit të minoriteteve.

Më 21 janar 1935 çështja i kaloi për shqyrtim Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës. Qeveria shqiptare e bazoi mbrojtjen e saj në parimin e barazisë së shtetasve para ligjit, ndërsa qeveria greke i mëshoi shkeljes së angazhimeve që qeveria shqiptare kishte marrë në Deklaratën e 2 tetorit 1921³⁰. Opinioni këshillimor i Gjykatës ishte se qëllimi kryesor i traktateve për mbrojtjen e minoriteteve ishte të siguronte jetesën paqësore mes minoritetit dhe maxhorancës, duke ruajtur në të njëjtën kohë karakteristikat që i diferencojnë minoritetet nga maxhoranca dhe duke kënaqur nevojat e tyre specifike. Për të arritur këtë duheshin plotësuar dy kushte: sigurimi i barazisë së plotë të minoriteteve me pjesën tjetër të popullsisë, si dhe sigurimi i mjeteve për mbrojtjen e karakteristikave të

²⁸ *AIH*, A. 5-59, fl. 6-7, Legata britanike në Durrës për FO, R.M. Hodgson për John Simon, çështja e reformës arsimore të Mirash Ivanajt, 3 maj 1933.

²⁹ *Po aty*.

³⁰ Cour permanente de Justice Internationale, *École minoritaire...* .

tyre të veçanta. Gjykata konsideronte se këto dy kushte janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën, pasi nuk mund të ketë barazi reale ndërmjet shumicës dhe minoritetit, nëse ky i fundit privohet nga institucionet e tij dhe detyrohet të heqë dorë nga ajo që përbën esencën e një minoriteti³¹.

Me vendimin e saj në favor të minoritetit grek, Gjykata e Hagës përcaktoi një standard në respektimin e minoriteteve. Standard që qeveria shqiptare e pranoi duke bërë ndryshimet e duhura në programet për shkollat e minoritetit duke ndryshuar në favor të gjuhës greke raportin e arsimimit të minoritetit grek. Pavarësisht se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare u shpreh kundër vendimit të qeverisë shqiptare për shkollat minoritare, nuk mendoj se qeveria shqiptare humbi realisht nga ky vendim. Shkollimi i minoritetit grek do të kryhej vërtet në gjuhën greke, por programet dhe mësuesit do të miratoheshin nga Ministria e Arsimit³². Në këtë mënyrë qeveria shqiptare arriti të forcojë kontrollin dhe mbi arsimin e minoritarëve grekë dhe të minimizojë influencën shoviniste greke në zonën e minoritetit grek. Qëllimi i reformës ishte forcimi i pavarësisë kombëtare dhe largimi i influencës së huaj, në këtë optikë qeveria shqiptare bëri një hap të rëndësishëm. Nga ana tjetër, qeverisë shqiptare iu krijua mundësia të negocionte hapjen e shkollave shqipe për minoritetin shqiptar në Greqi, madje dha rezultate në këtë drejtim³³.

Ajo që të bie në sy në këtë kohë, është pafuqia e Lidhjes së Kombeve për t'u imponuar të njëjtin standard edhe shteteve fqinjë të Shqipërisë. Ato, jo vetëm nuk kishin marrë asnjë masë për mbrojtjen e identitetit kombëtar të minoriteteve shqiptare në shtetet e tyre, por kishin ndjekur një politikë asimiluese dhe shkombëtarizuese.

³¹ Vladimir Ortakovski, *Minority in the Balkans*, New York: Transnational Publisher, Inc: Ardsley, 2004, f. 116.

³² A. Puto, *Shqipëria politike ...*, f. 505.

³³ Në vitin 1936, pas shumë bisedimesh, qeveria shqiptare arriti një marrëveshje me atë greke për të çelur shkolla shqipe për minoritetin shqiptar që jetonte në rajonin e Çamërisë.